



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_762_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 16 paragrafi 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V_572_2013 të datës 24 tetor 2013 për shoqërinë "Eurokos JH" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V_572_2013 të datës 24 tetor 2013, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) që bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, Komuna e Dragashit, të datë 06.10.2015 të shoqërisë "Eurokos JH" sh.p.k., rruga 20 "Zenun Beqa", Ferizaj, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V_572_2013 i datës 24 tetor 2013, i shoqërisë "Eurokos JH" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) që bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej **2.28 MW**, në Lumin Restelica, Komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit, gjegjësisht **deri me 24 tetor 2016**.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 29.09.2011 nga shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.33 MW që përbëhet prej gjashtë (6) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC "Brod I" (Brod) 1062 kW; HC "Brod II" (Dikance) 1250 kW; HC "Brod III"(Kukalane) 3120 kW; (totali 5432 kW) dhe HC "Restelica I" 1200 kW; HC "Restelica II" (Krushevë) 1200 kW dhe HC "Restelica III" (Globoqicë) 1498 kW (Totali 3898 kW), të gjitha në Komunën e Dragashit.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmime të prezantuara nga shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k., ka vendosur se ky aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 me datë 10 shkurt 2012. Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e



Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

- ZRRE me datë 07.08.2013 nga shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për dy (2) njësit gjeneruese HC "Brodi II" me kapacitet prej 1.25 MW dhe HC "Restelica II" me kapacitet prej 1.2 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë relevante.
- ZRRE me datë 21.10.2013 ka pranuar kërkesën me ndryshime për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC "Brodi II" me ndryshim të kapacitetit të instaluar nga 1.25 MW në 3.89 MW dhe HC "Restelica I" dhe II, të cilat janë bashkuar në një objekt të hidrocentralit me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtat mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin ujit, Lejet ndërtimore dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 24 tetor 2013 ka vendosur që shoqërisë "Eurokos JH" sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi V_572_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për **HC Brodi II. me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW dhe HC "Restelica I" & HC "Restelica II" (Krushevë)** që bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej **2.28 MW**, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë 06.10.2015 nga shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V_572_2013 të datës 24 tetor 2013, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) që bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit, për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.
- Shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se: *sa u përket punëve civile janë përfunduar, dhe tani janë në proces të montimit të tubacionit ku në tërësi punët në këtë hidrocentral janë kryer përafërsisht 60%. Arsyeja parashtrimit të kërkesës për shtyrje të afatit për HC Restelica 1& 2 ka të bëjë me atë, se kemi pasur të bëjmë me një teren mjaft të vështirë dhe në një territor me lartësi mbidetare mbi 1000 metra, ku edhe moti ka qenë jo i përshtatshëm për zhvillimin e punëve në mënyrë normale.*
- *Gjithashtu ka pasur vonesa sa i përket edhe mospërfundimit të shpronësimit të pronave nga ana e organeve kompetente komunale, dhe si pasojë e këtyre vonesave të shkaktuara jashtë vullnetit të firmës Eurokos JH sh.p.k., ka ndikuar që mos të premtim koha për shpronësimin e pronave nga fshati Mlike deri në fshatin Restelica, për të cilën jeni në dijeni. Pra, të gjitha këto kanë ndikuar në ngadalësimin e realizimit të punimeve si dhe paraqitjen e kërkesës për shtyrjen e afatit ligjor të vlefshmërisë së autorizimit edhe për një afat një (1) vjeçar, në mënyrë që të kompletohet ndërtim i hidrocentralit.*
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, të shoqërisë "Eurokos JH" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) që bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në





Lumin Restelica, komuna e Dragashit, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim V_572_2013 i datës 24 tetor 2013, pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi mund të shfuqizohet me datë **24 tetor 2016**, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar